



JANAR – QERSHOR 2011

**REPUBLIKA E KOSOVËS
QEVERIA E KOSOVËS
MINISTRIA E FINANCAVE**

BULETINI GJYSMËVJETOR MAKROEKONOMIK

**DEPARTAMENTI I POLITIKAVE EKONOMIKE
PRISHTINË**

PUBLIKUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE

Ndërtesa e Qeverisë, kati XIII

10,000 Prishtinë, Kosovë

Tel: ++ 381 38 200 34 331

WEBFAQJA
e maili

www.mf rks.org
makroekonomia@mfe ks.org

BORDI I EDITORËVE

Arment I. Merovci
Besart Myderrizi
Berat Havolli
Semra Tyrbedari
Valmira Rexhëbeqaj

Përdorimi i të dhënave nga ky publikim lejohet vetëm me citimin e burimit
Buletini publikohet në afat gjysmëvjetor dhe çdo përmirësim do të bëhet në web faqe
Ky botim përfshinë të dhënat e mbledhura deri më 30 Shtator 2011

Nëntor 2011

Përmbledhja

HYRJE	3
1. PASQYRA MAKROEKONOMIKE.....	4
1.1.1. LËVIZJA E ÇMIMEVE	5
MIRËQENIA SOCIALE.....	7
1.1.2. ASISTENCA SOCIALE.....	7
1.1.3. PENSIONI BAZË	8
2. SEKTORI FISKAL	9
2.1.1. TË HYRAT BUXHETORE QEVERITARE.....	9
2.1.2. TË HYRAT TATIMORE NGA KUFIRI	10
2.1.3. SHPENZIMET BUXHETORE QEVERITARE	14
3. SEKTORI FINANCIAR	17
3.1 ZHVILLIMET NË TREGUN KOMERCIAL BANKAR.....	18
3.2 STRUKTURA E DEPOZITAVE DHE KREDIVE	20
3.2.1 EKONOMITË FAMILJARE	20
3.2.2 KORPORATAT JO – FINANCIARE	21
3.3 STRUKTURA E KREDIVE SIPAS INDUSTRIË DHE AFATIT TË MATURIMIT	21
3.4 PROFITABILITETI DHE KONCENTRIMI NË SEKTORIN BANKAR.....	24
4 SEKTORI I JASHTËM	26
4.1 EKSPORTET	27
4.1.1 STRUKTURA.....	27
4.1.2 DESTINACIONI	28
4.2 IMPORTET	28
4.2.1 STRUKTURA.....	28
4.2.2 ORIGJINA.....	29

HYRJE

Ky edicion i Buletinit Gjysmëvjetor Makroekonomik paraqet të dhënat gjysmëvjetore të mbledhura nga institucionet përkatëse, të cilat janë përpunuar dhe analizuar me qëllim të ofrimit të informatave kualitative mbi trendet kryesore ekonomike që karakterizojnë gjysmën e parë të vitit 2011. Për më shumë ky dokument, përmban analiza sektoriale të cilat përfshijnë edhe vitin 2010, por theks i veçantë i është dhënë krahasimit të gjysmës së dytë të vitit 2011 me atë të vitit 2010.

Në përgjithësi gjatë pjesës së parë të vitit 2011, ecuritë ekonomike vlerësohen të jenë pozitive si në aspekt të rritjes ekonomike po ashtu edhe të stabilitetit makroekonomik e financiar. Bazuar në parashikimet e fundit makroekonomike, të realizuara në fillim të vitit 2011, ku reflektohen ndryshimet dhe trendet e fundit ekonomike, rritja ekonomike për vitin 2011 vlerësohet të jetë 5.3%.

Ekonomia e Kosovës, edhe gjatë kësaj periudhe ka vazhduar të ballafaqohet me deficit të lartë tregtar. Edhe përkundër faktit që gjatë kësaj periudhe eksportet shënuan një rritje prej rreth 16% rritja më e përshpejtuar e importeve prej rreth 16.5% ka kompensuar në një masë rritjen e eksporteve duke e lënë mbulueshmerinë e importeve nga eksportet ende në nivel të lartë.

Sa i përket sektorit financiar, ai ende vazhdon të mbetet stabil dhe likuid. Përkundër tronditjeve në tregun financiar botëror në vitet paraprake por edhe zhvillimeve të fundit në ekonominë e Eurozonës, asetet e sektorit financiar kanë shënuar një rritje vjetore prej 13.7%. Sektori bankar, duke kontribuar me një peshë të madhe në rritjen e sektorit financiar, ka vazhduar me rritjen kredidhënies, ku gjatë kësaj periudhe kreditë u rritën për 15.7% të cilat ishin tkurrur si rezultat i zhvillimeve të fundit financiare në botë. Po ashtu, besimi në bankat komerciale është rritur krahasuar me vitin paraprak, duke u pasqyruar në një rritje të konsiderueshme në depozita të këtij sektori prej 11.8%

Gjatë periudhës raportuese (Janar Qershor) Indeksi i Çmimit të Konsumatorit (IÇK) në mesatare shënoj ngritje prej 9.6%, me theks të veçantë ngritje shënuan çmimet e ushqimit dhe naftës.

Buletinit Gjysmëvjetor Makroekonomik përbëhet nga dy pjesë kryesore. Në pjesën e parë trajtohen vlerësimet për zhvillimin ekonomik dhe fiskal gjatë vitit 2010 dhe pjesa e dytë paraqet statistikën në detaje të sektorëve kyç ekonomik.

1. PASQYRA MAKROEKONOMIKE

Bazuar në kornizën makro fiskale, rritja reale e BPV së për vitin 2011 është parashikuar të jetë rreth 5.3%. Ky vlerësim i bërë në fillim të vitit, bazuar në të dhënat e fundit zyrtare mbi trendet aktuale ekonomike, duket të jetë i arritshëm. Një rritje e tillë pritet të ndodhë si rezultat i rritjes së vazhdueshme të konsumit privat dhe investimeve, e në veçanti investimeve publike.

Në këtë kontekst, niveli i importit i përdorur si indikator i nivelit të konsumit dhe investimeve në Kosovë, deri në fund të Qershorit arriti në €1,093 milion duke shënuar ngritje prej rreth 16.5% ndërsa që importi i prodhimeve që përdoren si lëndë e parë në investime është ngritur për rreth 45.4% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, dëshmon për rritje të konsumit dhe investimeve në përputhje me parashikimet. Në të njëjtën kohë edhe mbledhja e TVSH së që shfrytëzohet si indikator i trendit të konsumit privat në Kosovë, deri në fund të Qershorit 2011 ka arritur vlerën në €233.5 milion duke shënuar ngritje prej mbi 21% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, që po ashtu është në përputhje me trendet e importit gjatë kësaj periudhe. Ndërkaq që në të njëjtën kohë investimet publike për vitin 2011 të cilat kanë qenë të planifikuara të jenë rreth 40% të vlerës totale të buxhetit për vitin 2011, apo €595 milion deri në fund të Qershorit janë realizuar në masë prej rreth 30%.

Në të njëjtën kohë, eksportet kanë shënuar rritje prej rreth 16% krahasuar me periudhën e njëjte të vitit paraprak duke arritur në vlerë prej €164.2 milion, mirëpo rritja më e përshpejtuar e importeve ka kompensuar këtë rritje të eksporteve duke e lënë edhe më tutje mbulimin e importeve nga eksportet në nivel të ulët. Për sa i përket parashikimit të zhvillimit të tyre deri në fund të vitit, pritet që në harmoni me lëvizjen e çmimeve ndërkombëtare por edhe të rritjes së parashikuar ekonomike dhe masave të shtuara të kontrollit nga ana e Doganave të Kosovës, importet të arrijnë vlerën e parashikuar prej rreth €2.3 miliardë. Në të njëjtën kohë në trend me lëvizjen e çmimeve ndërkombëtare të metaleve si dhe rritjen e kërkesës botërore për metale, eksportet e mallrave në Kosovës pritet të realizohen në vlerën prej €336 milion, vlerë kjo e parashikuar në fillim të vitit .

Të dhënat aktuale mbi sektorin financiar po ashtu mbështesin vlerësimin për rritjen reale ekonomike gjatë vitit 2011. Edhe përkundër zhvillimeve negative të krizës financiare botërore, sektori financiar, e në veçanti sektori bankar, vazhdon të qëndrojë likuid dhe i shëndoshë. Kreditë e dhëna nga bankat komerciale deri në shtator 2011 janë rritur me një normë prej rreth 17%, ndërsa depozitat me 12%, duke dëshmuar se likuiditeti ishte i kënaqshëm, si dhe kërkesa për kredi dhe oferta e mjeteve të qytetarëve për depozita është rritur në përputhshmëri me vlerësimin për rritjen ekonomike.

Po ashtu, treguesit fiskal dëshmojnë që politika e fiskale e zhvilluar deri më tani ka vazhduar të mbështesë rritjen e projektuar ekonomike përmes shpenzimeve publike. Realizimi i shpenzimeve ka vazhduar sipas dinamikës së planifikuar me buxhet të vitit 2011. Deri në fund të Qershorit 2011, edhe përkundër aprovimit me vonesë të Buxhetit 2011, është arritur të ekzekutohet rreth 35% e buxhetit të planifikuar për këtë vit, duke dhënë një stimulim të vazhdueshëm të rritjes së ekonomike në vend përmes rritjes së kërkesës agregate.

Ndërkaq, në të njëjtën kohë edhe zhvillimet rreth të hyrave buxhetore kanë qenë shumë pozitive duke u arkëtuar rreth €580 milion deri në fund të Qershorit 2011, apo rreth 46% e planit vjetor, nga të cilat të hyrat e mbledhura nga Dogana janë €352 milion apo rreth 42% e planit vjetor ndërsa ato nga ATK mbi €121 milion apo rreth 47% e planit vjetor. Një realizim i tillë i të hyrave dëshmon për rritjen ekonomike në ekonominë e Kosovës e po ashtu edhe për aktivitetin e shtuar të institucioneve kryesore përgjegjëse për inkasim e të hyrave përmes ngritjes së profesionalizimit të këtyre institucioneve por edhe luftës së vazhdueshme për ulje të evazionit fiskal dhe ekonomisë jo formale.

Indeksi i çmimeve të konsumit është parashikuar të arrijë në 7.4% deri në fund të vitit 2011, kurse në pjesën e parë të vitit 2011 ky indeks ka regjistruar një rritje mesatare vjetore prej 9.6% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kur është shënuar një rritje mesatare vjetore prej 1.4%.

1.1.1. LËVIZJA E ÇMIMEVE


Gjysma e parë e vitit 2011 u karakterizua me rritje të theksuar të çmimeve të përgjithshme duke shënuar një ngritje mesatare vjetore prej 9.6% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kur është shënuar një rritje mesatare vjetore prej 1.4%. Kjo rritje e theksuar e çmimeve, kryesisht erdhi si rezultat i rritjes së theksuar të çmimeve të ushqimit dhe naftës në tregun ndërkombëtar të cilat në mesatare tejkaluan nivelin mesatar të çmimeve të shënuar për këtë periudhë. Duke pasur parasysh që një pjesë e madhe e produkteve ushqimore importohet dhe duke ditur që ushqimi përbën një pjesë të rëndësishme në shportën e konsumatorit, mund të konkludohet që rritja e çmimeve botërore të ushqimit është reflektuar edhe në nivelin e çmimeve të ushqimit në Kosovë.

Kjo ngritje e çmimeve në tregun ndërkombëtar është e ndikuar nga disa faktorë të cilën janë vazhdimësi e zhvillimeve nga gjysma e dytë e viti 2010 e që ndërlidhen me : (i) kushtet e pafavorshme klimatike në disa prej shteteve që cilësohen si eksportueset më të mëdha të grurit (Rusia, Kanada, Australia), (ii) Ndalimin e eksportit të grurit nga ana e Rusisë, (ii) ngritjen e vazhdueshme e çmimeve të produkteve bujqësore si rezultat i konkurrencës për toka bujqësore, si dhe e faktorë të ngjashëm. Të gjitha këto masa të përcjellura me rritje të vazhdueshme të kërkesës e në veçanti përdorimin e zgjeruar të produkteve bujqësore për prodhim të biodizelit kanë ndikuar në uljen e ofertës së grurit për ushqim dhe prodhimeve bujqësore, të cilat sollën presione inflacioniste.

Më specifikisht, çmimet e ushqimit dhe naftës në Kosovë gjatë periudhës Janar – Qershor 2011 u ngritën me një mesare vjetore prej 18% dhe 21% krahasuar me ngritjen prej 0.9% respektivisht 17.1% , të shënuar gjatë periudhës së njëjtë të vitit të kaluar. Në kuadër të çmimeve të ushqimit ngritje e theksuar u shënuar në çmimet e bukës dhe drithërave prej 44.8% krahasuar me rënien prej 1.4% sa shënuan gjatë periudhës së njëjtë të vitit të kaluar. Po ashtu ngritje e theksuar u shënuar në çmimet e vajit dhe sheqerit të cilat u ngritën me një mesatare vjetore prej 46% , respektivisht 20.2% gjatë muajve Janar Qershor 2011.

Përpos vrotjimit të lëvizjes së indeksit të përgjithshëm të çmimeve, indikator të rëndësishëm paraqet niveli i inflacionit baze (IÇK përjashtuar ushqimin dhe naftën), që në përgjithësi do të duhej të tregonte nivelin e inflacionit vendor apo në këtë rast do të përjashtonte ndikimin e tronditjeve që vijnë nga lëvizja e çmimeve të importit. Ky indeks gjatë kësaj periudhe ka shënuar një rritje mesatare vjetore prej 2.1% gjatë vitit 2011 krahasuar me vitin 2010 kur ajo ishte 0.6%. Kjo vërteton faktin që rritja e theksuar e çmimeve të përgjithshëm në Kosovë, është e ndikuar nga rritja e çmimeve të ushqimit dhe naftës.

Duke qenë që në përgjithësi ky indikator në shtete tjera tregon për nivelin e brendshëm të inflacioni, në rastin e Kosovës nuk mund të konkludohet një gjë e tillë. Duke qenë që në rastin e Kosovës edhe produktet si rryma, mobiliet, furnizimet e ndryshme për shtëpi, por edhe ushqimet e servuara në hotele dhe restorante kryesisht janë produkte të importit. Andaj çmimet e importit kanë ndikim edhe në çmimet që do të duhej të jenë të ndikuara nga faktorë të brendshëm, që kanë të bëjnë me konkurrueshmëri dhe produktivitet.




Burimi: Enti i Statistikës së Kosovës dhe kalkulimet e departamentit të makroekonomisë

MIRËQENIA SOCIALE

1.1.2. ASISTENCA SOCIALE

Duke qenë që Kosova vlerësohet të jetë një ndër shtetet më të varfëra në rajon, me një shkallë të theksuar të varfërisë, skema e asistencës sociale e menaxhuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) gjegjësisht nga Departamenti Asistencës Sociale së bashku me të hyrat nga remitencat shërbejnë si e hyrë të rëndësishme për familjet të cilat vlerësohen të jetojnë në gjendje të rëndë ekonomike. Raporti i fundit i publikuar nga Banka Botërore 2011¹, vlerëson që 34 % e popullsisë në Kosovë jetojnë nën kufirin e varfërisë absolute prej €1.55 në ditë, ndërsa që 12% jetojnë nën kufirin e varfërisë ekstreme prej 1.02 %. Edhe përkundër përmirësimit të ndjeshëm të nivelit të varfërisë krahasuar me raportin paraprak, të publikuar nga Banka Botërore (2007), ku u vlerësua që rreth 45% e popullsisë së Kosovës jetojnë në varfëri, varfëria edhe më tej mbetet shqetësim serioz i shoqërisë/ekonomisë kosovare.

Sipas të dhënave të MPMS së në fund të Qershorit 2011 ishin 35,803 familje përfituese të skemës sociale. Të hyrat që secila familje përfiton nga kjo skemë ndryshon në varësi të numrit të anëtarëve të familjes dhe kriterëve të përcaktuara me ligjin përkatës. Vlen të theksohet fakti që përkundër rënies së vazhdueshme në numrin e familjeve përfituese që është shënuar në vazhdimësi nga gjysma e dytë e vitit 2008, ky trend ka ardhur duke u ngritur gjatë vitit 2009 dhe 2010, ndërsa që gjatë pjesës së parë të vitit 2011 ka ngelur pothuajse në nivel të njëjtë me atë të gjysmës së dytë të vitit 2010.




Burimi: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

¹ Raporti i Bankës Botërore 2011 përmban ndryshime metodologjike në vlerësimin e varfërisë krahasuar me vlerësimin paraprak

1.1.3. PENSIONI BAZË

Pensioni bazë është përcaktuar si përfitimi mujor fiks që i ofrohet të gjithë qytetarëve të Kosovës me moshë mbi 65 vjeç. Vlera e këtij pensioni nga Janari 2009 u rrit në €45 nga €40 sa ishte më herë. Duke filluar nga muaji Mars 2008, Qeveria e Kosovës, aprovoi udhëzimin administrativ me të cilën i mundësohet pagesa mujore shtesë, për të gjithë ata persona që kanë kontribuar se paku 15 vjet në sistemin e vjetër të pensioneve. Kjo vlerë shtesë u përcaktua të jetë €35 mbi pensionin bazë, duke rezultuar në vlerë totale prej €80 në muaj. Grafiku i më poshtë pasqyron, numrin e përfituesve nga të dy skemat si dhe pagesat mujore përkatëse.



Burimi: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Të dhënat e raportuara nga MPMS dëshmojnë që numri i personave, përfitues të pensionit bazë në fund të vitit 2010 ishte 108,632 ndërsa i atyre kontribut pagues ishte 31,731.

2. SEKTORI FISKAL


Roli i Qeverisë në ekonomi vazhdon të jetë i një rëndësie të madhe duke pasur parasysh që Qeveria përmes politikave fiskale ndikon në stabilizimin dhe rritjen e ekonomisë me qëllim të përmirësimit të të hyrave për ekonominë familjare dhe ngritjen e mirëqenies. Qeveria e Kosovës mbetet gjithnjë e përkushtuar në implementimin e politikave të matura me qëllim të ruajtjes së qëndrueshmërisë fiskale dhe në të njëjtën kohë stimulon ngritjen ekonomike. Duke qenë që politika fiskale është i vetmi instrument i politikave ekonomike në Kosovë, vendimet për bërjen e politikave fiskale kërkojnë analizë të mirëfilltë dhe të kujdesshme me qëllim të mos krijimit të ndonjë tronditje të thellë në pozitën e bilancit tregtarë i cili është një parametër i rëndësishëm i pozitës ekonomike të një vendi.

2.1.1. TË HYRAT BUXHETORE QEVERTARE

Të dhënat për gjashtëmujorin e parë të vitit 2011 tregojnë për një përmirësim të aktivitetit ekonomik, i cili kryesisht është i ndikuar nga konsumi, investimet dhe eksporti. Për me shumë, gjatë këtij gjysmë vjetori, eksporti është rritur për 15.8% përderisa importi me 16.5%. Këto zhvillime tregojnë që edhe të hyrat buxhetore kanë performuar dhe do të performojnë dukshëm më mire se në vitin 2010 duke mundësuar kështu realizimin e planit në fund të vitit.

Më saktësisht, të hyrat buxhetore gjatë kësaj periudhe kanë arritur vlerën prej €579.2 milionë apo 8.6% më të larta se në periudhën e njëjtë të vitit 2010. Të hyrat nga kufiri kanë qenë 20.4% më të larta se ato në gjysmën e parë të vitit 2010 duke arritur vlerën prej €352.1 milionë përderisa të hyrat nga tatimet vendore kanë shënuar rritje prej 19.8% krahasuar me të njëjtën periudhë dhe kanë arritur në €121.4 milionë. Përkundër rritjes rapide të të hyrave nga taksat, të hyrat totale duket se janë rritur me një normë më të ulët, si rezultat i dividendës më të ulët të deklaruar nga Posta dhe Telekom i Kosovës (PTK) dhe Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës 'Adem Jashari'. Për më tepër, kjo dividendë këtë vit është planifikuar të jetë €35 milionë apo €50 milionë më e ulët se në vitin 2010. Po ashtu, të hyrat vetanake të komunave dhe ato të nivelit qendror kanë treguar trend të njëjtë si në gjysmë vjetorin e parë të vitit 2010 gjë që ka ndikuar në një normë më të ulët të rritjes së të hyrave të përgjithshme buxhetore. Në grafikun e mëposhtëm është ilustruar trendi i të hyrave të përgjithshme sipas kategorive.

Figura 2.1 Të Hyrat Buxhetore 2010-2011, në miliona euro



Burimi: Departamenti i Thesarit


Siç shihet edhe në grafik, rritja e theksuar e importit ka ndikuar në një grumbullim më të madh të të hyrave nga kufiri. Po ashtu, marrë parasysh ngritjen e çmimeve ndërkombëtare të ushqimit dhe naftës si dhe ngritjes së vazhdueshme të efikasitetit të Doganave të Kosovës, të hyrat nga kufiri pritet të performojnë me një trend të tillë edhe në kuartalet në vijim. Më saktësisht, në pjesën e parë të vitit 2011, të hyrat doganore arritën pjesëmarrjen prej 65% në të hyrat totale krahasuar me 63% sa ishin në periudhën e njëjtë të vitit 2010. Performancë të kënaqshme kanë shënuar edhe të hyrat vendore. Për më shume, të hyrat vendore kanë mbajtur pjesëmarrjen e njëjtë në të hyrat totale në nivel prej 22% sikurse edhe në periudhën e njëjtë të vitit 2010.

2.1.2. TË HYRAT TATIMORE NGA KUFIRI

Siç edhe është parashikuar, kategoria e të hyrave nga 'Taksa Doganore' në kufi ka vazhduar të shënoj trend rritës. Në gjysmën e parë të vitit 2011 kjo kategori arriti vlerën prej €50.9 milionë dhe u ngrit me 11.4% krahasuar me vlerën prej €45.7 milionë në gjysmën e parë të vitit 2011.

Kjo ngritje e kësaj kategorie të të hyrave i atribuohet kryesisht ngritjes së importeve, si në volum ashtu edhe në vlerë (rezultuar nga ngritja e çmimeve të komoditeteve bazë të cilat në rastin e Kosovës përbëjnë përqindje mjaft të lartë në import). Grafiku më poshtë ilustron të hyrat nga kjo kategori në kuartalet për të parë lëvizjet e kësaj kategorie dhe pjesën kohore kur këto të hyra patën fazën e performancës më të mirë. Siç shihet, gjatë gjysmës së parë të vitit 2011 kjo kategori e të hyrave pësoi ngritje relativisht të lartë në të dy kuartalet. Duhet cekur që lëvizjet në këtë kategori ndryshojnë krahas lëvizjeve në volumin e importit të komoditeteve dhe lëvizjes së çmimit të tyre në tregun ndërkombëtarë.


Figura 2.2 Të hyrat tremujore nga tatimi doganor, në miliona euro



Burimi: Shërbimi doganor i Kosovës

Të hyrat nga **'Taksa e Akcizës'** që grumbullohet në kufi ka vazhduar me trend rritës edhe gjatë kësaj pjese të vitit 2011. Për më shumë, të hyrat nga kjo taksë kanë arritur vlerën prej €120.9 milionë e që korrespondon me një ngritje prej 30.5% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2010. Vlen të theksohet se akciza është një taksë e cila aplikohet në produkte të caktuara që konsiderohen produkte luksoze dhe vlera e aplikuar e saj në këto produkte është relativisht e lartë. Po ashtu, kjo taksë është specifike që nënkupton që grumbullimi i saj varet nga volumi i importit të produkteve në të cilat aplikohet kjo taksë dhe nuk ka ndonjë ndërlidhmëri me lëvizjen e çmimeve. Andaj, këtu vlen të ceket fakti që gjatë vitit 2010 është bërë ngritja e akcizës të disa produkteve dhe gjatë vitit 2011 pritet të reflektohet efekti i plotë i kësaj ngritjeje.


Figura 2.3 Të hyrat tremujore nga taksa e akcizës në kufi, në miliona euro



Burimi: Shërbimi doganor i Kosovës


Për sa i përket të hyrave të mbledhura nga **'TVSH në kufi'**, gjatë pjesës së parë të vitit 2011 kjo kategori ka shënuar një ngritje prej 16.9% duke arritur vlerën prej €197.4 milionë. Kjo ngritje e të hyrave nga kjo

kategori i atribuohet kryesisht ngritjes së importeve prej 16.5% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2011, gjë që pjesërisht ka ardhur si rezultat i ngritjes së çmimeve ndërkombëtare.



Burimi: Shërbimi doganor i Kosovës


Të hyrat nga ‘**TVSH të mbledhur në vend**’ po ashtu kanë treguar një rritje të theksuar gjatë kësaj periudhe duke arritur shumën në €54.1 milionë e që korrespondon me një ngritje prej 36.5% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2010. Kjo ngritje i atribuohet kryesisht ngritjes së konsumit shoqëruar edhe nga ngritja e çmimeve në vend e po ashtu edhe vazhdimet të projekteve të mëdha të investuara nga ana e Qeverisë.



Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës

‘**Tatimi në të ardhura personale**’ paraqet një kategori të rëndësishme duke pasur parasysh që struktura e tregut të punës në Kosovë përbëhet nga një fuqi punëtore relativisht e re. Kjo kategori e tatimit përfshinë të hyrat nga pagat dhe të hyrat tjera që mund të vijnë nga aktivitete të ndryshme biznesore.


Të hyrat në të ardhura personale për periudhën në vërtetim kanë performuar relativisht mirë duke arritur vlerën prej €36.3 milionë apo një ngritje prej 3.2% krahasuar me pjesën e parë të vitit 2010. Në kuartalin e parë të vitit 2011, kjo kategori e të hyrave ka pësuar rënie krahasuar me vitin 2010 e që vjen si rrjedhojë e vonësës së aprovimit të buxhetit dhe si rezultat pagat e shërbyesve civil të muajit Mars janë paguar në muajin Prill përfshirë këtu edhe rritjen. Po ashtu, vlen të ceket që edhe përkundër faktit që në Janar të vitit 2009 është bërë ulja e normës së tatimit në të ardhura personale, të hyrat nga kjo kategori kanë regjistruar rritje të kënaqshme gjë që sugjeron që ulja e normës mund të ketë ndikuar në zgjerimin e bazës tatimore në vitet në vijim.



Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës

Për dallim nga tatimi në të ardhura personale, ulja e normës së **‘Tatimit në të hyra të korporatave’**, nuk ka treguar ngritje në të hyra nga kjo kategori. Kjo rënie mund të justifikohet edhe me faktin që në kohën kur është bërë ndryshimi, në botë, e në veçanti në vendet e zhvilluara, ka mbizotëruar kriza ekonomike dhe financiare e cila në një masë ka ndikuar edhe në performancën e bizneseve në Kosovë. Në këtë kontekst, niveli i të hyrave nga ky tatim ndërlidhet me normën e rritjes ekonomike e cila gjatë vitit 2009 ka qenë vetëm rreth 3% ndërsa që në vitin 2010 ekonomia e Kosovës është ngritur me 4%. Me kalimin e krizës dhe rimëkëmbjen e ekonomisë botërore e po ashtu nën supozimin e mos thellimit të mëtejshëm të krizës së euro zonës, pritet edhe një performancë më e mirë e të hyrave nga kjo kategori e të hyrave. Për më shumë, gjatë pjesës së parë të vitit 2011, të hyrat e grumbulluara nga ky lloj tatimi kanë arritur vlerën prej €30.5 milionë një ngritje prej 23.3% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2010.

Figura 2.7 Të hyrat nga tatimi në të ardhurat e korporatave, në miliona euro




Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës

2.1.3. SHPENZIMET BUXHETORE QEVERTARE

Shpenzimet buxhetore të planifikuara për vitin 2011 janë rreth 15% më të larta sesa ato të vitit 2010 duke arritur vlerën prej €1.4 miliardë. Kjo ngritje e shpenzimeve ka qenë kryesisht e ndikuar nga ngritja e pagave të kategorive të caktuara të shërbyesve civil, ngritja e lehtë e kategorisë së mallrave dhe shërbimeve, ngritja e konsiderueshme e subvencioneve, në veçanti për kategoritë e dala nga lufta si dhe ngritja e theksuar e investimeve kapitale të Qeverisë, që kryesisht ka të bëjë me projektin e madh të ndërtimit të autostradës Merdarë Morinë. Të gjitha këto zhvillime kanë ndikuar që bilanci bankar i planifikuar për fund të vitit të arrijë në €123 milionë apo rreth 2.7% të BPV së. Në figurën 2.8 janë paraqitur shpenzimet sipas kategorive ekonomike në baza vjetore.

Shpenzimet rrjedhëse: kjo kategori e shpenzimeve përbën shpenzimet kyçe mbështetëse të operacioneve ditore të Qeverisë dhe përbëjnë rreth 60% të shpenzimeve totale buxhetore. Kjo kategori, krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2010 është ngritur për 1.6% duke pësuar një rënie prej 8.6 pika të përqindjes në pjesëmarrjen e tyre në total të shpenzimeve të përgjithshme.

Pagat dhe mëditjet të cilat përbëjnë rreth 29% të kontributit në shpenzimet totale në vitin 2011 u rritën për 24%, nga €311.4 milionë sa ishin në fund të vitit 2010 në €386 milionë sa janë planifikuar për vitin 2011. Kjo ngritje vjen pas vendimit të qeverisë për ngritje të pagave për kategori të caktuara të shërbyesve civil për vitin 2011. Për sa i përket shpenzimeve të kësaj kategorie gjatë gjysmës së parë të vitit 2011, pagat dhe mëditjet kanë pësuar një ngritje të lehtë prej 1.1% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.




Burimi: Departamenti i thesarit dhe i buxhetit

Mallrat dhe shërbimet kanë vazhduar me trend rritës më të ngadalësuar dhe në vitin 2011 kjo kategori u rrit për 2.7%, duke arritur vlerën prej €187 milionë për vitin 2011. Në pjesën e parë të vitit 2011 janë shpenzuar rreth €60 milionë apo 8.3% më pak sesa në periudhën e njëjtë të vitit 2010.

Subvencionet dhe transferet si kategori e cila përbën rreth 24% të kontributit në shpenzimet totale të ndara për vitin 2011, arritën vlerën prej €272 milionë apo 7.2% më të larta se shpenzimet në këtë kategori në vitin 2010. Kjo ngritje kryesisht është ndikuar nga ngritja e nivelit të përfitimeve për kategoritë e dala nga lufta. Nga kjo shumë e ndarë për subvencione dhe transfere, €34 milionë janë ndarë për subvencionimin e ndërmarrjeve publike kryesisht për import të energjisë elektrike dhe pagesat për shfrytëzimin e energjisë elektrike nga ana e rasteve sociale si dhe subvencione për ngrohjen qendrore.

Shpenzimet kapitale vazhdojnë të jenë kategori e rëndësishme në shpenzimet e përgjithshme buxhetore, duke pasur parasysh që kjo kategori përbën rreth 38% të pjesëmarrjes në ndarjet totale buxhetore për vitin 2011. Përgjatë periudhës raportuese, kjo kategori arriti vlerën prej €170 milionë nga €110 milionë sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit 2010. Në këtë kontekst, duhet veçuar faktin që investimet në infrastrukturë të cilat janë duke u rritur në vazhdimësi kanë qenë kontributi kryesorë në rritje të kësaj kategorie gjatë vitit 2011 dhe është parashikuar të rritet edhe përgjatë viteve vijuese pasi që nevoja për përmirësim të infrastrukturës së rëndë është ende e lartë në Kosovë.



Burimi: Departamenti i thesarit

Struktura e shpenzimeve sipas funksionit tregon se edhe përgjatë gjysmës së parë të vitit 2011 shpenzimet Qeveritare u përqendruan kryesisht në kategorinë e ekonomisë që kryesisht përfshinë investimet kapitale me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës së rëndë dhe stimulimit të investimeve. Kjo kategori e cila përbën rreth 33% të shpenzimeve totale gjatë periudhës së vrojtuar është ngritur me 67% nga €102 milionë sa ishte në vitin 2010. Mbrojtja sociale e cila përbën rreth 16% të shpenzimeve sipas këtij klasifikimi është ngritur me 8% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2010 ndërsa mbrojtja edhe pse me një pjesëmarrje prej 2% në shpenzimet totale ka pësuar një ngritje prej 29%.

3. SEKTORI FINANCIAR

Gjysmëvjeteri i parë i vitit 2011 në përgjithësi u karakterizua me një stabilitet të sektorit financiar botëror pas krizës financiare që tronditi këtë sektor përgjatë periudhës 2008 dhe 2009. E raportuar në publikimet e kaluara, kriza financiare botërore nuk patë ndikim të theksuar në tregun financiar vendorë, megjithatë, gjatë asaj periudhe u vërejt ngadalësim në rritjen e kredidhënies dhe rënie në profitin bankar. Me stabilizimin e tregjeve financiare ndërkombëtare, tregu financiar vendor fitoj besimin e lëkundur duke reflektuar në rritje të kënaqshme në depozita, ku si rrjedhojë e kësaj ngritjeje u reflektua dhe në rritje në kreditim të sektorit privat.


Kjo periudhë raportuese u karakterizua në masë të madhe me probleme të vazhdueshme me financat publike të Qeverive të ndryshme, probleme të cilat ishin më evidente në shtetet e ashtuquajtura periferike të eurozonës si Spanja, Portugalia, Irlanda, Itali e me theks të veçantë Greqia. Nga këto zhvillime të borxheve publike dhe deficiteve buxhetore u ndikua në një masë të theksuar rritja ekonomike në shtetet e lartpërmendura si dhe pasiguria në tregjet financiare filloj të vërehet. Edhe përkundër këtyre zhvillimeve, nga të dhënat e disponueshme, ekonomia vendore dhe në veçanti tregu financiar nuk pati ndikim negativ, megjithatë, rekomandohet për një kujdes të veçant karshi këtyre zhvillimeve dhe sidomos kujdes në investimet nëpër tregje financiare evropiane dhe më gjerë.

Gjatë periudhës raportuese, pasqyrat e sektorit financiar në Kosovë tregojnë për zgjerim të vazhdueshëm të këtij sektori. Deri në fund të muajit Qershor të vitit 2011 asetet totale të sektorit financiar shënuan €3.2 miliardë, shifër kjo e cila përfaqëson një ngritje vjetore prej 13.7%. Struktura e sektorit financiar në Kosovë ka përbërje dominuese nga bankat komerciale. Në sektorin financiar në Kosovë duke mos ndryshuar nga viti paraprak, aktivitetet bankare vazhdojnë të zhvillojnë tetë banka komerciale, nga to, dy me pronësi/kapital vendorë dhe gjashtë me pronësi/kapital të huaj. Asetet totale të sektorit bankar përbëjnë diku rreth 76% të asetëve totale të sektorit financiar ku bankat me pronësi vendore përbëjnë vetëm 6% të totalit të asetëve kundrejt 70% pjesëmarrje nga bankat me pronësi të huaj.

Për më shumë, profiti në sektorin bankar shënoj vlera negative në fillim të vitit 2010 për tu këndellur në muajt vijues. Gjatë gjysmëvjetorit të dytë të vitit 2010, profiti i sektorit bankar vazhdoi trendët e saja pozitive për të arritur në vlerë prej €36.6 milion në fund të muajit Dhjetor. Gjysmëvjeteri i parë i vitit 2011 shënoj profit prej €14.9 milion, që përfaqëson një rënie në profitin e sektorit bankar për €2.2 milion në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo rënie në profit pjesërisht i atribuohet ngritjes së shpenzimeve përjashtuar shpenzimet për interes si dhe pjesërisht nga humbjet e shkaktuara nga kreditë jo performuese të cilat shënuan një ngritje më të shpejt në krahasim me periudhat paraprake.

Edhe gjatë kësaj periudhe raportuese, sektori bankar vazhdon t'i orientoj një pjese të konsiderueshme të mjeteve të saja në tregjet e huaja financiare. Nga të dhënat e publikuara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) vërehet se vlera totale e mjeteve të huaja neto (MHN) arritën vlerën prej €1.9 miliard, shumë e cila përfaqëson një ngritje vjetore prej afro 14%. Mjetet e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) vazhdojnë të përfaqësojnë shumicën e mjeteve të investuara jashtë vendit (59%), pasuar nga korporatat e tjera depozituese (21%) dhe pjesa e mbetur nga korporatat e tjera financiare.

Figura 3.0 Mjetet e Huaja Neto të Korporatave Financiare (MHN), në miliardë euro



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Si përfaqësues i dytë për nga madhësia në asetet totale të sektorit financiar janë fondet pensionale, e në veçanti mjetet në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK). Këto mjete deri në Qershor 2011 shënuan €540 milion apo 16% të aseteve totale të sektorit financiar pasuar nga institucionet mikrofinanciare (4%) dhe kompanitë e sigurimeve (3%).

3.1 ZHVILLIMET NË TREGUN KOMERCIAL BANKAR

Përgjatë periudhës raportuese, në tregun vendor operojnë tetë banka komerciale, ku në gjashtë prej tyre dominon kapitali i huaj ndërsa dy prej tyre kanë pronësi vendore. Asetet totale në sektorin bankar arritën vlerën prej €2.5 miliard në Qershor të vitit 2011 ku nëse krahasohet me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar vërehet një ngritje prej 12.7% në asetet totale. Ndërsa nëse shikojmë raportin në mes të aseteve totale të sektorit bankar me vlerësimin e BPV për vitin 2011 vërejmë se ky raport nuk pati ndryshim të theksuar me vitin e kaluar për të mbetur në nivel prej 58%. Ky raport konsiderohet të jetë relativisht i ulët në krahasim me disa vende të tjera të rajonit dhe më gjerë, dhe si i tillë mund të shërbej si indikator i rëndësishëm për potencialin e investimeve dhe zhvillimit të këtij sektori.


Sikurse viteve të kaluara, bankat komerciale vazhduan të plasojnë një sasi të mjeteve të tyre si investime në letra me vlerë. Gjatë tri viteve të kaluar, bankat komerciale patën qasje të ndryshme karshi investimeve në letra me vlerë nëpër tregjet e huaja financiare. Këto investime pas një rënie gjatë viteve 2008 dhe 2009, si rezultat i zhvillimeve negative nëpër tregjet e huaja financiare, gjatë vitit 2010 dhe posaçërisht 2011, shënuan rritje të theksuar. Kthimi në investimet në letra me vlerë erdh si rezultat i rimëkëmbjes së sektorit financiar botëror dhe në veçanti ekonomisë globale dhe si rrjedhojë edhe sjellja investive bankare ndryshoj karshi ambientit të ri të krijuar. Pas një rënie të theksuar të investimeve në letra me vlerë, bankat komerciale filluan ti orientojnë mjetet e tyre drejt tregjeve financiare botërore, ku në Qershor të vitit 2011 investimet në letra me vlere arritën vlerën prej €205.6 milion, shifër e cila është më e lart për 80% në krahasim me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar.

Bazuar në raportet financiare të publikuara nga bankat komerciale, mund të themi se sistemi bankar në Kosovë vazhdon të jetë stabil dhe i qëndrueshëm. Nga këto raporte vërehet se kreditimi nga sektori

bankar për sektorin real ka vazhduar të jetë gjithnjë në ngritje, edhe pse kjo ngritje është ngadalësuar nga viti 2008 e më tutje. Nga figura 3.1 mund të vërehet se kreditimi i sektorit bankar për sektorin real shënoj rritjen e saj më të theksuar diku në fillim të vitit 2008. Megjithatë, si rezultat i krizës financiare botërore rritja e kreditimit filloj të bie në vitet vijuese për të arritur pikën më të ulët në fillim të vitit 2010. Si rezultat i tejkalimit të krizës financiare, bankat filluan të rrisin kreditimin dhe kjo pasqyrohet në grafikun në fjalë ku vërehet rritja në kreditim nga gjysmëvjetori i dytë i vitit 2010 dhe më tutje. Në fund të muajit Qershor të vitit 2011 kreditë bruto arritën vlerën prej €1,625 milion shifër e cila përfaqëson një rritje vjetore prej 15.7%. Gjithashtu, nëse shikojmë pjesëmarrjen e kredive në asetet totale bankar vërehet një ngritje prej 2% në fund të muajit Qershor të vitit 2011 në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ose thënë ndryshe, kreditë morën pjesë në asetet totale me 65%.

Njëlloj sikurse kreditë, depozitat në sektorin bankar vërehen të kenë pasur një trend të ngjashëm të ngritjes së ngadalshme vjetore përgjatë tri viteve të kaluara. Pas një rënie nga mesi i vitit 2008 si rezultat i krizës financiare, depozitat patën një ngritje të kënaqshme në fund të vitit 2009 dhe fillim të vitit 2010. Të dhënat nga BQK tregojnë se depozitat në fund të muajit Qershor 2011 arritën në nivelin prej €1,958 milion, shifër e cila përfaqëson një ngritje vjetore prej 11.8%.

Siç mund të shihet në figurën 3.1, rritja vjetore e depozitave filloj të bie në një masë të konsiderueshme në gjysmëvjetorin e dytë të vitit 2008, rënie e cila vazhdoi deri në muajin Shtator të vitit 2009 edhe përkundër ngritjes së normave të interesit në depozita përgjatë kësaj periudhe. Fillimi i vitit 2010 njohu një ngritje vjetore të theksuar në depozita për të shënuar rënie në pjesën e dytë të vitit. Ndërsa pjesa e parë e vitit 2011 tregon për një ngritje vjetore konstante me një mesatare prej 14%.




Kjo rënie në rritjen vjetore të depozitave kryesisht i atribuohet ngadalësimit të zhvillimit të sektorit real dhe si rrjedhojë fuqisë gjeneruese të kursimeve nga ekonomitë familjare si përbërës kryesor të depozitave. Për sa i përket raportit mes depozitave dhe BPV, ky raport mbeti pothuajse i pandryshuar nga viti paraprak në nivel prej 45% të BPV. Ky parametër dhe parametrat e lartë cekur tregojnë se hapësira për zhvillim dhe zgjerim të mëtutjeshëm në sektorin financiar ekziston, dhe futja e bankave tjera duhet inkurajuar me qëllim të rritjes së konkurrencës dhe gjithnjë ofrimit të shërbimeve bankare sa më të favorshme për sektorin real.

3.2 STRUKTURA E DEPOZITAVE DHE KREDIVE

3.2.1 EKONOMITË FAMILJARE

Depozitat në sektorin bankar duke mos ndryshuar nga periudhat paraprake vazhduan të rriten, edhe pse me ritme më të ngadalshme në krahasim me vitet e kaluara. Ky ngadalësim në rritjen e depozitave erdh si rezultat i vështërsive financiare që u manifestuan gjatë viteve të krizës financiare (2008-2009). Sikurse gjatë viteve të kaluara, depozitat e ekonomive familjare dominuan depozitat në sektorin bankar duke arritur në €1,246 milion shifër e cila përfaqëson një rritje vjetore prej afro 18%. Kjo ngritje vjetore kryesisht i atribuohet përmirësimit të sektorit real (pas krizës financiare botërore, e cila megjithatë pati ndikim marginal në sektorë të caktuar) që rezultojë me aftësinë kursyese më të lartë për ekonomitë familjare, si dhe pjesërisht rënies në depozita që rezultojë gjatë vitit 2009 dhe 2010.




Burimi: Banka Qëndrore e Kosovës

Për sa i përket kredive për ekonomitë familjare, ato pothuajse përshkuan një trend horizontal përgjatë vitit 2010 dhe 2011 për të arritur vlerën prej €482 milion në fund të muajit Qershor. Kjo shifër përfaqëson një ngritje prej 18% nëse krahasojmë Qershorin e vitit 2011 me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Vlen të ceket se kredite për ekonomitë familjare përgjatë 2010 dhe gjashtë mujorit të parë të vitit 2011 patën rritje mujore në mesatare prej 2%. Duke u bazuar në këto shifra mund të themi se sektori bankar vepron me një kujdes të veçantë karshi kërkesave të ekonomive familjare.

3.2.2 KORPORATAT JO – FINANCIARE

Edhe gjatë kësaj periudhe raportuese, si përfitues kryesor i kredive vërehet të jenë korporatat jo financiare. Në fund të Qershorit të vitit 2011 vlera e tyre arriti në €1,115 milion ku nëse krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar vërehet një ngritje prej 13.5%. Siç mund të shihet nga figura 3.4, kreditë drejtuar korporatave jo financiare shënuan një rënie në rritjen vjetore përgjatë vitit 2009 për të shënuar vlera negative në Shkurt të vitit 2010. Ky shtrëngim në dhënien e kredive erdhi kryesisht nga vështërsitë që kaloi sektori real pas krizës financiare globale. Megjithatë, së bashku me përmirësimin e ambientit ekonomik global dhe vendor në gjysmë pjesën e dytë të vitit 2010, kreditë dhënë korporatave jo financiare filluan të stabilizohen dhe të shënojnë ngritje vjetore. Ky përmirësim vazhdojë edhe gjatë pjesës së parë të vitit 2011 por me ritëm më të shpejt.



Burimi: Banka Qëndrore e Kosovës

Ndërsa sa u përket depozitave ato vazhduan të mbeten në një nivel pothuajse të njëjtë me periudhën paraprake. Në fund të muajit Dhjetor të vitit 2010, depozitat e korporatave jo financiare shënuan €292.6 milion, përderisa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ato ishin €250 milion, apo një ngritje vjetore prej 17%.

3.3 STRUKTURA E KREDIVE SIPAS INDUSTRIË DHE AFATIT TË MATURIMIT

Si përfitues kryesor i kredive në industrinë Kosovare vazhdon të jetë sektori i shërbimeve, sektor i cili në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2011 absorboj më se 71% të totalit të kredive. Kreditë drejtuar këtij sektori në fund të periudhës raportuese kapën shumë më prej €802 milion, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar vërejmë një ngritje prej 16.7%. Gjithashtu, vlen të ceket se përbrenda sektorit të shërbimeve, tregtia është absorbuesi kryesor i kredive me një pjesëmarrje prej 81%, pjesëmarrje e cila patë ngritje prej 2% në krahasim me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar.

Njëlloj me vitin e kaluar, si përfitues vijues i kredive vërehen të jenë kreditë për industri, energji dhe ndërtimtari, ku kreditë për ndërtimtari vazhduan të shënojnë ngritje të theksuar. Ato në Qershor të vitit

2011 kapën vlerën prej €122 milion, shifër e cila përfaqëson një ngritje vjetore prej afro 10%. Kjo rritje e vazhduar e kredi dhënies për sektorin e ndërtimtarisë vjen kryesisht si rezultat i zhvillimit të hovshëm të këtij sektori.

Sa i përket sektorit bujqësor, kreditë dhënë këtij sektori si përqindje në totalin e kredive vërehen të kenë mbetur në nivelet e ngjashme me periudhat e kaluara, ku pjesëmarrja e tyre shënoj 4% në totalin e kredive. Siç duket, në perceptcionin e bankave, sektori bujqësor paraqet një risk më të lart ndaj të cilit sektori bankar duket se vepron me kujdes më të shtuar.


Sa i përket afatit të maturimit të kredive për korporatat jo financiare, nga raportet bankare vërejmë se pjesa dërmuese e kredive, diku afër 40% si pjesëmarrje në totalin e kredive për korporata jo financiare, janë me afat maturimi mbi 2 vite dhe deri në 5 vite (shih Tabela 1), kredi të cilat shënuan ngritje për 12%. Përderisa, vërejmë një ngritje të kredive me afat maturimi deri në 1 vit afro 27% krahasuar me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar, dhe me një pjesëmarrje prej 30%. Vërehet se kreditë me afat maturimi më të lart, pra mbi 5 dhe deri në 10 vite përfaqësuan afro 20% të kredive për korporatat jo financiare dhe ato mbi 10 vjet 3%.

Tabela 1. Kreditë Sipas Afatit të Maturitetit

Pershkrimi	GJ1 2010	Gj2 2010	Gj1 2011
<i>Kreditë, në miliona euro</i>			
Korporatat Tjera jo Financiare			
Deri në 1 vit	268.8	266.5	342.3
Mbi 1 vit dhe deri në 2 vite	68.5	61.9	81.9
Mbi 2 vite dhe deri në 5 vite	390.9	428.9	439.5
Mbi 5 vite dhe deri në 10 vite	217.6	222.3	217.7
Mbi 10 vite	38.2	33.3	33.6
Ekonomitë Familjare			
Deri në 1 vit	23.3	25.0	34.6
Mbi 1 vit dhe deri në 2 vite	27.4	29.1	45.7
Mbi 2 vite dhe deri në 5 vite	192.6	201.9	223.6
Mbi 5 vite dhe deri në 10 vite	138.5	146.5	148.3
Mbi 10 vite	27.4	28.6	29.9

Siç mund të shihet nga Tabela 1, sa u përket afatit të maturitetit të kredive për ekonomitë familjare ato u dominuan nga kreditë me afat maturitet mbi 2 vite dhe deri në 5 vite (46.4%). Këto kredi shënuan një rritje vjetore prej 16%. Pasuar nga kreditë me afat maturimi mbi 5 dhe deri në 10 vite me një pjesëmarrje prej 30%, dhe me një rritje vjetore prej 7%.


Figura 3.4 Kreditë sipas maturitetit, në miliona euro



Burimi: Banka Qëndrore e Kosovës

Në anën tjetër, struktura e depozitave sipas kategorive të definuara dallon nga ato të kredive. Siç mund të shihet nga figura e mëposhtme, depozitat e ekonomive familjare vazhdojnë të jenë përbërësi kryesor i totalit të depozitave me një pjesëmarrje prej 68% ne totalin e depozitave. Për më shumë, depozitat e ekonomive familjare në fund të Qershorit të vitit 2011 shënuan një ngritje stabile në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, dhe kjo ngritje raportohet të jetë 14.5%. Kryesisht kjo ngritje i atribuohet përmirësimit të sektorit real vendor dhe ati ndërkombëtar si dhe kjo ngritje mund të ketë ardhur nga fitimi i besimit të sektorit financiar gjë që mund të ketë reflektuar dhe në ngritjen e besimit të individëve karshi bankave.

Figura 3.5 Depozitat sipas afatit të maturitetit, në miliona euro




Burimi: Banka Qëndrore e Kosovës

Depozitat me afat maturimi deri në 1 muaj janë në nivelin më të ulët si për korporatat jo financiare ashtu dhe për ekonomitë familjare dhe për dallim me vitin e kaluar kjo kategori shënoj një rritje te lehtë.

Nga Figura 3.7 mund të shihet se ekonomitë familjare dhe bizneset kanë tendencë të depozitojnë mjetet e tyre në afate relativisht të shkurtra (mbi 1 vit dhe deri në 2 vite).

3.4 PROFITABILITETI DHE KONCENTRIMI NË SEKTORIN BANKAR

Profitabiliteti në sektorin bankar është paraqitur ne figurën e mëposhtme dhe matet përmes kthimit në asete, (që paraqet sa profitabile është një bankë në raport me asetet totale) i paraqitur në boshtin e djathtë të figurës dhe kthimit në ekuitet (që paraqet profitabilitetin nga investimet e aksionarëve) në boshtin e majtë. Siç mund të shihet në figurën e mëposhtme, në fillim të vitit 2010, më specifikisht në Janar, te dy matësit e profitabilitetit shënuan vlera negative. Kjo rënia e profitabilitetit kryesisht i atribuohet investimeve bankare jashtë vendit, të cilat gjeneruan kthime të ulëta shkaktuar nga kriza financiare. Gjithashtu një rolë të veçantë në këtë rënie luajti dhe ngritja e interesit në depozita që reflektoj nga rritja e konkurrencës në sektorin bankar dhe nevoja për likuiditet. Fillimi i vitit 2011 ishte më i mirë se sa fillim vitit i kaluar, te dy matësit e profitabilitetit ishin në territorin pozitiv. Megjithatë, në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2011 profiti bankar ishte më i ulët ne raport me vitin e kaluar. Nëse raportojmë në vlera monetare, atëherë profiti i sektorit bankar shënoj €14.9 milion, vlerë e cila ishte më e ulët për €2.2 milion në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.




Burimi: Banka Qëndrore e Kosovës

Koncentrimi në sektorin bankar raportohet përmes Indeksit Herfindalh Hirschman (IHH). Siç mund të shihet nga figura 3.9 koncentrimi në sektorin bankar ka pësuar rënie të vazhdueshme prej vitit 2007. Ky trend rënës i koncentrimit ka përshkimit të njëjtë pas vitit 2007 si për asete ashtu për kredi dhe depozita. Në fund të periudhës raportuese, IHH për asete shënoj 2,231 pikë shifër e cila përfaqëson një rënie prej 266 pikë. Gjithashtu, trend rënës përshkoj edhe koncentrimi bankar në tregun për kredi, ku IHH në gjysmëvjetorin e dytë të vitit 2011 ishte 2,129 shifër e cila përfaqëson një rënie prej 261 pikë në krahasim me gjysmëvjetorin e parë të vitit 2010. E njëjta vlen dhe për tregun për depozita, treg në të cilin koncentrimi bazuar në IHH ra për 214 pikë. Ky trend rënës në koncentrimin bankar kryesisht i atribuohet hyrjeve të bankave të reja në tregun vendor si dhe ofrimin e produkteve të reja nga bankat ekzistuese në mënyre që ta zgjerojnë pjesëmarrjen e tyre në treg.

Figura 3.7

Koncentrimi në Sektorin Bankar (IHH)




Burimi: Banka Qëndrore e Kosovës

4 SEKTORI I JASHTËM

Kosova vazhdon të ketë ekonomi relativisht të hapur dhe të integruar në rajon dhe më gjerë duke pasur parasysh nivelin e lartë të importit të mallrave dhe shërbimeve në Kosovë. Të dhënat për tregtinë me jashtë për gjashtë mujorin e parë të vitit 2011 japin indikacione pozitive për trendin e ngritjes së eksporteve. Megjithatë, pavarësisht rritjes së eksporteve trendi i importeve vazhdon të jetë i lartë gjë që vazhdon të shkaktojë deficit të lartë tregtar.

Importet vazhduan të kenë pjesëmarrje relativisht të lartë në BPV në përgjatë viteve paraprake, dhe ky trend parashihet të vazhdoj edhe në vitet në vijim, që është kryesisht e ndikuar nga trendi i konsumit në Kosovë. Statistikat për tregtinë me jashtë për gjysmë vjetorin e parë të vitit 2011 tregojnë se bilanci tregtar arriti vlerën prej €929.3 milion ku importet u rritën për 16.5% nga €938.8 milion sa ishin në gjysmë vjetorin e parë të 2010 në €1,093 milion në gjysmë vjetorin e dytë 2011. Grafiku i paraqitur më poshtë pasqyron rrjedhën e zhvillimeve të bilancit tregtar të Kosovës përgjatë viteve 2009 2011 në kuartale:



Burimi: Enti Statistikor i Kosovës


Eksportet të cilat në krahasim me importet përbëjnë përqindje relativisht të ulët në pjesëmarrje të BPV së kanë vazhduar të kenë trend pozitivë të rritjes përgjatë viteve të fundit. Të dhënat e fundit për gjysmë vjetorin e parë të vitit 2011 tregojnë se eksportet kanë shënuar rritje prej rreth 15.8%, nga €141.7 milion në gjysmë vjetorin e parë të vitit 2010 në €164.2 milion. Duhet theksuar se pavarësisht rritjes së vazhdueshme të eksporteve kjo nuk ka ndikuar në uljen e deficitit tregtar pasi që vlera nominale e produkteve të eksportuara në krahasim me produktet e importuara është dukshëm më e ulët. Mallrat e importuara janë relativisht të diversifikuara dhe me pesha të balancuara në importin total ndërsa eksportet vazhdojnë edhe më tutje të jenë të koncentruara kryesisht tek metalet bazë të cilat përbëjnë rreth 65% të eksportit total, të cilat në vlera nominale në gjysmë vjetorin e parë të 2011 u rritën për 16% nga €91.5 milionë në €106.5 milionë.

4.1 EKSPORTET

4.1.1 STRUKTURA

Eksportet vazhdojnë të jenë të koncentruara kryesisht në produktet e metaleve bazë të cilat përbëjnë rreth 65% të eksportit total të përcjellur nga produktet e mineraleve me 13%, ushqimore 6%, plastika dhe druri me 4%, makineritë dhe pajisjet elektrike me 3% dhe produktet e tjera të cilat kryesisht përfshijnë produktet konsumuese përbëjnë rreth 9% të eksportit total.


